

Rruga drejtë së vërtetës 31



Tani le të ndjekim ajetin 89 të sures Bekare.

"E kur u erdhi atyre prej All-llahut libri (Kur'ani) që është vërtetues i atij, që e kishin pranë, e që para se t'u vinte e kërkonin ndihmën e tij kundër mosbesimtarëve, e mohuan atë (Muhammedin) që e njihnin, kur u erdhi. Pra mallkimi i Allahut qoftë kundër mosbesimtarëve!"

Në emisionet e mëparshme përmendëm disa shembuj të mosbindjes së Beni izraelitëve ndaj Hazretit Musa dhe urdhrave të Teuratit. Ky ajet flet për jahuditë në kohën e shfaqjes së Islamit të cilët në bazë të shenjave të Teuratit mbi Profetin e Islamit prisnin ardhjen e tij dhe kishin emigruar nga rajonet e tyre në drejtim të Hixhazit. Jahuditë që banonin në Medine dhe në rrethinat e saj u thoshin idhujtarëve të Medines se së shpejti do të vijë një profet i quajtur Muhamed të cilit ne do ti besojmë dhe ai do të jetë fitim tar mbi armiqtë. Por kur profeti shkoi në Medine, idhujtarët e Medines e besuan atë, ndërsa jahuditë për shkak të ekstremizmit dhe interesave të ngushta, e mohuan atë duke mohuar edhe përmbajtjen e Teuratit. Ky ajet tregon se njohja dhe dituria nuk mjaftojnë, por nevojitet edhe shpirti i pranimit të së vërtetës. Megjithëse çifutët dhe në veçanti dijetarët e tyre e njihnin profetin e Islamit, ata nuk pranuan të vërtetën dhe nuk iu bindën atij.

Tani le të ndjekim ajetin 90 të sures Bekare.

"E shëmtuar është ajo për çka ata e shitën vetveten. Atë që e shpalli All-llahu të mos e besojnë nga zilia, për shkak se All-llahu nga mirësia e Tij t'i shpallë atij që dëshiron nga robët e vet. Andaj merituan zemërim mbi zemërim (gazep mbi gazep). Mosbesimtarët kanë dënim që i poshtëron".

Jahuditë prisnin që edhe profeti i Islamit të ishte nga raca Beni Izrael, por kur e panë se ai ishte arab nuk e pranuan Islamit për shkak të ekstremizmit racial dhe zilisë. Madje ata kritikuan edhe këtë veprim të Zotit. Padyshim që jahuditë me këtë veprim bënë një tregti të dëmshme sepse ata për të pranuan profetin e premtuar kishin duruar vështirësitë e shumta të udhëtimit në Medine, por vetëm për shkak të egoizmit dhe xhelozisë e mohuan të vërtetën dhe e shitën veten për shkak të zilisë dhe nuk arritën qëllimin e tyre.

Në vazhdim le të ndjekim ajetin 91 të sures Bekare.

"Dhe kur atyre u thuhet: "Besoni atë që e shpalli All-llahu", ata thonë: "Ne besojmë atë që na u shpall neve", kurse e mohojmë atë pas tij, edhe pse është vërtetues i atij, që e kanë ata dhe është i vërtet. Thuaj: "Nëse jeni besimtarë, pse i mbytnit më parë pejgamberët e All-llahut?"

Ky ajet u drejtohet jahudive duke u thënë nëse ju nuk besoni Muhamedin sepse ai nuk është i racës tuaj, atëherë përse i mohuat dhe i vratë profetët e tjerë që ishin të racës tuaj? Pra ju jeni kundërshtarë të së vërtetës qoftë nëse ajo thuhet nga profetët tuaj apo nga Profeti i Islamit, qoftë

e shkruar në librin tuaj apo në Kuran. Në princip shkrimet në librat hyjnorë janë të gjitha nga një Zot dhe për të gjithë popujt dhe nuk i përkasin një race apo kombi të caktuar. Si rrjedhim askush nuk mund të thotë se unë u besoj atyre që janë shpallur profetit tim dhe nuk pranoj asgjë tjetër. Përmbajtjet e të gjithë librave hyjnorë kanë të njëjtin orientim dhe nuk kanë asnjë kontradiktë mes tyre, por vetëm ndryshime të kuptueshme sipas epokave ashtu siç librat e universiteteve ndryshojnë nga ato të shkollave të mesme.

Në vazhdim do të ndjekim ajthin **92** të sures **Bekare**.

"Juve u pat ardhur Musai me argumente, por pas tij ju e adhuroat vëcin, pra ju ishit mizorë".

Jahuditë e kundërshtuan Profetin e islamit me pretekstin se ai ishte arab, por edhe në kohën e Musait kur ai shkoi në malin Tur, beni izraelitët filluan të adhurojnë vëcin duke bërë një padrejtësi shumë të madhe ndaj profetit të tyre i cili kreu disa nga mrekullitë më të qarta.

Më poshtë do të ndjekim ajetin **93** të sures **Bekare**.

"(Përkujtoni) Kur morëm premtimin tuaj dhe mbi ju ngritëm kodrën Tur, (u thamë) merrni këtë që u dhamë seriozisht dhe dëgjoni (respektoni). Ata thanë: "Dëgjuam (me vesh) e kundërshtuam". E për shkak të mosbesimit të tyre, adhurimi ndaj vëcit ishte përzier me gjak në zemrat e tyre. Thuaj: "Nëse jeni besimtarë, besimi juaj është duke u udhëzuar keq"."

Thamë se një nga pretekstet e çifutëve për të mos pranuar profetin e Islamit ishte se ai nuk ishte nga Beni izraelitët. Ata pretenduan se pranojnë vetëm profetë që të jetë nga raca e tyre dhe zbatojnë vetëm librin e Musait, Teuratin. Kurani sjell shembuj që tregojnë se jahuditë nuk besojnë as profetin e tyre Musa dhe as librin e tij Teuratin dhe veprojnë në kundërshtim me urdhrat e këtij libri. Zoti në malin Tur mori disa premtime nga beni izraelitët dhe u kërkoi atyre të zbatojnë zotimet, por ata megjithëse dëgjuan, nuk u bindën. Kjo për faktin se etja për të mirat e kësaj botë që u shpreh me dashurinë e tyre ndaj vëcit të artë i kishte pushtuar aq shumë zemrat e tyre sa që nuk kishte lënë vend për mendim dhe besim dhe është interesant fakti se megjithë këto mosbindje, ata pretendonin se janë besimtarë. Kurani iu përgjigj edhe atyre duke u drejtuar një pyetje: Vallë besimi juaj ju shtyn të thyni zotimin e Zotit? Të adhuron vëcin dhe të vrisnin profetët hyjnorë? Nëse është kështu, besimi juaj po ju urdhëron për keq.

Tashmë do të ndjekim mësimet e nxjerra nga këto ajete:

1- Nëse sot shikojmë se të krishterët dhe çifutët nuk besojnë Islamin, nuk duhet të kemi dyshim tek drejtësia e Islamit sepse shumë prej tyre megjithëse e kuptojnë të vërtetën, për shkak të interesave të ngushta dhe të vogla nuk e pranojnë atë ashtu si jahuditë e Medinesë të cilët e njohën profetin e Islamit, por nuk e pranuan atë.

2- Zilia është burim i mosbesimit dhe i mohimit të së vërtetës. Beni izraelitët ngaqë e panë se profeti i Islamit nuk është nga raca e tyre e kundërshtuan atë të shtyrë nga ndjenja e zilisë dhe egoizmit.

3- Dashuria ekstreme për gjëra të tjera përveç Zotit, çfarëdo që të jenë është e rrezikshme sepse e verbon njeriun dhe nuk e lejon atë të shikojë të vërtetën. Kur statuja e artë e një vici zuri vend në zemrat e beni izraelitëve, ata harruan urdhrat e Zotit, Muasait dhe Teuratit dhe u zhytën në mosbesim dhe idhujtari.

Marre nga: <http://albanian.trib.ir>